




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Klan Kosova
Adriatik Kelmendi
Drejtör
Prishtinë

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/313 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Klan Kosova
(Pala Përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 28 maj 2013 ka nxjerrë Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01. Me këtë rregullore është përcaktuar mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
2. KPM me datë 18 gusht 2021, mori Vendim që Pala përgjegjëse të sanksionohet me Vërejtje për shkelje të nenit 3, paragrafi 3, dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale.
3. KPM ka bërë monitorimin e Palës përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me rregulloret e KPM-së: Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale si dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, lidhur me transmetimin e përmbajtjeve programore të cilat mund të jenë të dëmshme për fëmijë dhe të mitur. Monitorimi është bërë për 24 orë brenda një jave nga data 22 deri 26 tetor 2021.
4. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 2 nëntor 2021 ka gjetur se Pala përgjegjëse me datën 2 nëntor ka transmetuar serialin shqip “HOT” të cilin e ka kategorizuar me shenjen 10+ edhe përkundër asaj se ky serial i përket kategorisë së tretë 14+ ku gjatë të cilit janë transmetuar skena të papërshtatshme jashtë kohës së përcaktuar me Rregullore.
5. KPM, po ashtu ka gjetur se Pala përgjegjëse me datën 26 dhe 28 tetor 2021 ka transmetuar serialet “*Brooklyn Nine-Nine*” rreth orës 12:12, “*Dashuri dhe urrejtje*” rreth orës 13:13, “*Apartamenti i Pafajësisë*” rreth orës 11:16 “*FC Lata*” rreth orës 12:12 si dhe emisionin “*Alibi*”, rreth orës 13:35 të cilat i ka paralajmëruar dhe shoqëruar me shenjen 10+ mirëpo janë transmetuar jashtë kohës së lejuar me Rregullore. Gjithashtu, piktogramet nuk janë paraqitur me ngjyrat përkatëse siç janë përcaktuara me Rregullore.

6. KPM, në bazë të Raportit të monitorimit, ka gjetur se Pala përgjegjëse me datën 26 tetor 2021 gjatë transmetimit të emisionit “Ora e Pasdites” ka transmetuar rubrikën për fëmijë e tipit garues “Super mendje” ku ka bërë reklamim dhe tele-promocion, KPM, po ashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse në emisionin “Ora e Pasdites” në rubrikën për fëmijë e tipit garues “Super mendje” ka bërë vendosje të produkteve, duke vepruar edhe në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07.
7. KPM, gjithashtu në bazë të Raportit të monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse me datë 24 tetor 2021, gjatë transmetimit të emisionit argëtues “Wazup” ka bërë transmetimin e një videoklipi muzikor i quajtur “Çka bone” në të cilin ka përdorim të gjuhës vulgare e cila nuk duhet të transmetohet para kohës së kufizimit duke vepruar kështu edhe në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
8. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 9 nëntor 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM 2013/01 dhe Rregulloren KPM-2017/07, dhe të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 duke i ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh të përgjigjen dhe të ofrojnë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e lartpërmendura.
9. KPM nuk ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse pas dërgimit të Njoftimit për shkelje.
10. KPM pas Njoftimit për shkelje ka bërë edhe një monitorim të dytë për të parë nëse Pala përgjegjëse ka ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01. Rregulloren KPM-2017/07 dhe të Kodit të Etikës KKPM-2016/03. Monitorimi është bërë për datat 1, 4 dhe 7 dhjetor 2021 dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 14 dhjetor 2021 është gjetur se Pala përgjegjëse ka vazhduar të transmetojë përmbajtje programore të cilat janë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/01, duke i paralajmëruar dhe shoqëruar me shenjen 10+ mirëpo janë transmetuar jashtë kohës së lejuar me Rregullore.

Analiza ligjore

11. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2013/01, Rregullores KPM-2017/07 dhe të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
12. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 3, Kufizimet dhe obligimet e përgjithshme, paragrafi 1 të Rregullores KPM-2013/01, të cilët përcaktojnë se:

“ Shërbyesit medial audio-vizuel nuk do të transmetojnë programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, përveçse në kohën dhe kushtet e përcaktuara me këtë rregullore.”
13. KPM në bazë të Raporteve të monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse gjatë ditëve të monitoruara ka vepruar në kundërshtim me nenin e lartcekur gjatë transmetimit të serialit shqip “HOT”, i cili nuk është transmetuar në kohë dhe në kushte e përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01.

14. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim edhe të nenit 6, Koha e Transmetimit, paragrafi 2 dhe 3, dhe nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores KPM-2013/01, të cilët përcaktojnë se:

“2. Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së dytë mund të bëhet prej orës 15:00 deri në ora 06:00.”

“3. Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së tretë, mund të bëhet prej orës 22:00 deri në ora 06:00.”

15. KPM në bazë të Raportit të monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse me datën 26 dhe 28 tetor 2021 ka transmetuar serialet “*Brooklyn Nine-Nine*” rreth orës 12:12, “*Dashuri dhe urrejtje*” rreth orës 13:13, “*Apartamenti i Pafajësisë*” rreth orës 11:16 “*FC Lata*” rreth orës 12:12 si dhe emisionin “*Alibi*”, rreth orës 13:35 të cilat i ka paralajmëruar dhe shoqëruar me shenjen 10+ mirëpo janë transmetuar jashtë kohës së lejuar me Rregullore. Sipas Rregullores KPM-2013/01 programet e kategorisë së dytë mund të transmetohen prej orës 15:00-06:00 dhe programet e kategorisë së tretë mund të transmetohen prej orës 22:00-06:00.

16. KPM gjithashtu ka konstatuar se Pala përgjegjëse në serialet e transmetuara nuk i përdorë piktogramet e parapara me Rregulloren KPM-2013/01 duke bërë shkelje të nenit 7, Shenjat dhe piktogramet, paragrafi 1, i cili përcakton se:

“ Subjektet transmetuese do të përdorin piktogramet të paraqitura në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje.”

17. KPM, po ashtu në bazë të Raporteve të monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim edhe me Rregulloren KPM-2017/07, ku me datën 26 tetor 2021 gjatë transmetimit të emisionit “*Ora e Pasdites*” ka transmetuar rubrikën për fëmijë e tipit garues “*Super mendje*” ku ka bërë reklamim dhe tele-promocion, duke vepruar në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 2, të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07, i cili përcakton se:

“Tele-promocioni nuk duhet të paraqitet në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut do të zbatohen për tele-promocionin”

18. KPM, po ashtu ka konstatuar se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të emisionit “*Ora e Pasdites*” në rubrikën për fëmijë e tipit garues “*Super mendje*” ka bërë vendosje të produkteve, duke vepruar edhe në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07.

19. KPM, gjithashtu në bazë të Raportit të monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar edhe në kundërshtim me Kodin të Etikës KKPM-2016/03, ku me datën 24 tetor 2021, gjatë transmetimit të emisionit argëtues “*Wazup*” ka bërë transmetimin e një videoklip muzikor i quajtur “*Çka bone*” në të cilin ka përdorim të gjuhës vulgare e cila nuk duhet të transmetohet para kohës së kufizimit duke vepruar kështu edhe në

kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“OSHM nuk duhet të transmetojnë para kohës së kufizimit (nga ora 24:00 në 05:00) asnjë material që përmban gjuhë vulgare dhe ofenduese.”

20. KPM, ka konstatuar se Palën përgjegjëse edhe pas Njoftimit për shkelje të dërguar nga KPM ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01. Duke u bazuar në Raportin e dytë monitorues është konstatuar se Pala përgjegjëse ka vazhduar të transmetojë përmbajtje programore të cilat janë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/01, duke i paralajmëruar dhe shoqëruar me shenjen 10+ mirëpo janë transmetuar jashtë kohës së lejuar me Rregullore.
21. Komisioni si rrethanë rënduese për Palën përgjegjëse ka konsideruar dështimin e vazhdueshme të këtij ofruesi të shërbimeve mediale për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01, Rregulloren KPM-2017/07 dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
22. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje nenit 3, paragrafi 1, nenit 6, paragrafi 2 dhe 3 dhe nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, si dhe për shkelje të nenit 12 paragrafi 1 dhe nenit 15 paragrafi 2.2, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe nenit 4 paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.


Vendim

23. Pala përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumë prej 1,000 (njëmijë) euro në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 3, paragrafi 1, nenit 6, paragrafi 2 dhe 3 dhe nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, si dhe për shkelje të nenit 12 paragrafi 1 dhe nenit 15 paragrafi 2.2, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe nenit 4 paragrafi 1 Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
24. Obligohet Pala përgjegjëse që në afat prej dhjetë (10) ditësh të bëjë kategorizimin e filmave dhe serialeve të cilat i transmeton, t'i paralajmërojë ato para fillimit me sinjal verbal dhe akustik dhe t'i identifikojë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre sipas kategorizimit të programeve të përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01. Të mos vendosë produkte dhe të mos bëjë reklamim në ekran të ndarë në emisione të fëmijëve, ashtu siç përcaktohet në Rregulloren KPM-2017/07. Të mos transmetoj videoklipe muzikore në të cilat ka përdorim të gjuhës vulgare, para kohës së kufizimit, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për ankesë

25. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

26. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



21.12.2021
Datë